



## NDËRTESE E RE ME EFIÇIENCË ENERGJETIKE PËR REZULTATE MË TË MIRA BIZNESI

**N.T.P. Butterfly** merret me paketimin dhe shitjen e produkteve higjienike. Kompania furnizon disa nga supermarketet më të mëdha në Kosovë me produkte higjienike për femra dhe pelena për fëmijë. Në portofolion e kompanisë ka rreth 30 produkte dhe kërkesa për produktet e Butterfly po rritet çdo ditë.

Biznesi i Butterfly fillimisht ishte vendosur në një ambient me qira në një ndërtesë të vjetër, pjesërisht i përshtatur për t'u përdorur si magazinë dhe pjesërisht për paketimin e produkteve. Ndërtesa nuk përmbushte kërkesat minimale të Shëndetit dhe Sigurisë për të punësuarit.

Me ndihmën e Programit për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë së NVM-ve në Kosovë, kompania investoi në ndërtimin e një ndërtese të re për prodhim si dhe për zyra administrative, duke përfshirë instalimin e sistemeve elektrike dhe instalimin e një sistemi modern HVAC. Butterfly transferoi të gjitha operacionet e biznesit në ndërtesën e re, e cila është me eficientë ndaj energjisë dhe do ta ndihmojë kompaninë të kursejë energji dhe të ul kostot operacionale. Përveç kësaj, ambientet e reja garantojnë një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm për punëtorë e saj.

Butterfly fitoi ndihmë teknike falas për të optimizuar projektin e saj të investimit dhe gjithashtu fitoi grant në vlerë prej 15% pas verifikimit të suksesshëm të projektit, financuar nga Bashkimi Evropian.

Me këtë investim kompania tani plotëson një larmi standardesh evropiane, duke përfshirë:

- Rregullorja (KE) Nr. 1005/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 shtatorit 2009 për substancat që shkatërrojnë shtresën e ozonit;
- Direktiva 2008/98 / EC për mbeturinat
- Direktiva 2012/27 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 Tetorit 2012 mbi eficientë e energjisë, duke ndryshuar Direktivat 2009/125 / EC dhe 2010/30 / BE dhe duke shfuqizuar Direktivat 2004/8 / EC dhe 2006/32 / EC
- Direktiva 89/654 / EEC lidhur me Kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për vendin e punës;

Vlera e kredisë € 250,000

Vlera e grantit € 37,500

Direktivat e BE-së të plotësuara

Rregullorja mbi eficientë e energjisë, për substancat që shkatërrojnë shtresën e ozonit, për mbeturinat dhe kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për vendin e punës

Investuar në

ndërtimi i një ndërtese të re për prodhim si dhe për zyra administrative

Konsulentët implementues

